*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

E hënë, 27 shtator 2021

[Seancë e hapur]

[I akuzuari paraqitet përse videolidhjes]

--- Fillon në orën 11.31 paradite

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë dita. Znj. Sekretare ju lutem paraqitni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.

Së pari do të kërkoj të prezantohen palët.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita, sot kemi Alex Whiting zëvendës Prokurorin e Specializuar, zotin Michalczuk Prokuror, Sivia D’Ascoli, Julie Mann menaxhere e lëndës dhe Filippe De Minicis ndihmës Prokuror.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësja e Viktimave.

ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës. Mirëdita të gjithëve. Ekipi i Mbrojtjes së Viktimave përfaqësohet sot nga Liesbeth Zegveld bashkëmbrojtëse, Marie-Pier Barbeau nëpunëse e lartë juridike dhe unë Anni Pues Mbrojtëse e Viktimave.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Avokati i Mbrojtjes.

Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës. Përfaqësohemi nga unë Julius Von Bone kryeavokat, zoti Betim Shala bashkëmbrojtës dhe zoti Fatmir Pelaj përkthyes dhe hetues. Përmes videolidhjes na bashkohet dhe z. Mustafa, i akuzuari.

Nëse mundet Z. Mustafa do të na bashkohet edhe në datë 4 tetor mes videolidhjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Z. Avokat.

Z. Mustafa a punon mirë lidhja, na dëgjoni mirë?

I AKUZUARI: Po zonja Gjykatëse, mirë shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë, shumë mirë. Vë re se edhe z. Hans van de Wal Mbrojtës Kujdestar për Dëshmitarin 4600 ndodhet këtu.

Për procesverbal sot paraqiteni para Trupit Gjykues numër 1. Sot kemi planifikuar të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04600.

Zonja Shoqëruese, a mund ta shoqëroni Dëshmitarin të hyjë në sallë ju lutem.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët përsëri z. Dëshmitar. A pate fundjavë të mirë?

DËSHMITARI: Po, faleminderit, të mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, sot do të vijojmë me dëshminë tënde. Përpara se të

fillojmë dua të kalojmë shumë shkurt në seancë private.

Znj. Sekretare ju lutem të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës jemi në seancë private tani.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.

Z. Dëshmitar, dua të të informoj se të kemi dhënë garanci javën që shkoi, këto garanci janë ende të vlefshme, e kupton këtë?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare mund të rikthehemi në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi rikthyer në seancë publike, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, të rikujtoj se je nën betim për të thënë të vërtetën, E kupton këtë?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

Avokati i Mbrojtjes, ditën e premte na informuat se sipas vlerësimit tuaj ju duhen edhe 15 minuta të tjera për të bërë disa pyetje. Kështu vlen akoma ky vlerësim?

Z. VON BONE: [Përkthim] Besoj se 15, 20 minuta maksimumi. Disa çështje të shkurtra mund t'i kalojmë shumë shpejt.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. dëshmitar, do t'ia jap fjalën Avokatit Mbrojtës për të vijuar me disa pyetje për ty.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Keni fjalën Z. Avokat.

DËSHMITARI: W04600 [Vazhdim]

Pyetje të palës tjetër Z. Von Bone: [Vazhdim]

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. Mirëmëngjesi z. Dëshmitar.

Pë. Mirëmëngjesi.

Py. Z. Dëshmitar, a e njeh një person qoftë gjatë luftës apo që vinte nga fshati *[REDAKTUAR]*?

Pë. Të lutem edhe një herë pyetjen se s'e kuptova.

Py. A e njeh një person, a ke njohur një person gjatë luftës i cili ishte nga një fshat apo nga një vend *[REDAKTUAR]*?

Pë. Kam njoft shumë, jo një po kam njoft shumë.

Py. Një person me emrin *[REDAKTUAR]* që vinte nga fshati *[REDAKTUAR]*?

Pë. Ka shumë *[REDAKTUAR]* që kam, ndoshta kam njoft. Jo nja po ndoshta dy, tre, pesë.

Py. Po ndonjë në veçanti është që e ke njohur gjatë luftës, apo me të cilin kishe kontakte gjatë luftës?

Pë. Unë kena pas ushtarë me mbiemër *[REDAKTUAR]*, jo një po ka pas shumë ushtar. Tash nuk e di për cilën është fjala.
Py. Një person me emrin *[REDAKTUAR]*, a e njeh?
Pë. Jo. S'më kujtohet.
Py. A njeh *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*?
Pë. Jo, s'më kujtohet.
Py. A të kujtohet nëse ka pasur ndonjë punonjës i policisë ushtarake me mjekër?
Pë. Jo, nuk më kujtohet.
Py. A njeh një person me emrin *[REDAKTUAR]*?
Pë. *[REDAKTUAR]*. Po.
Py. Kush ishte?
Pë. Pseudonimin e ka pas *[REDAKTUAR]*.
Py. Po emrin e vërtetë si e kishte?
Pë. *[REDAKTUAR]*.
Py. Çfarë pozite mbante?
Pë. Nuk e di.
Py. Nga e njeh, nga ke dëgjuar për të?
Pë. E njof pej kurit ka ardh si ushtar në brigadën Zllash atje e njof. Përpara s'e kom njoft.
Py. Po si ushtar ku ishte i vendosur ai?
Pë. Ka qenë në brigadë 153 në Zllash.
Py. Po tamam tamam, në ç'vend ndodhej, në ç'vend ishte vendosur ai?

Pë. Po brigada ka qenë në shkollën e Zllashit, po ndoshta ka mujt me konë edhe në ndonjë njësi tjetër që unë nuk e kam dit.
Py. Z. Rrahman Dini, a kishte ndonjë asistent?
Pë. Po. *[REDAKTUAR]*.
Py. Dhe veç këtij personi, Z. Dini a kishte ndonjë asistent tjetër?
Pë. Ndoshta ka pas se ai ka qenë i sëmur. Ndoshta ka pas edhe tjera asistenta, po unë nuk e di tash cilën, po e di që pikërisht ky ma shumë ka qëndru me të.
Py. Z. Dini, a ishte përgjegjës për ndonjë gjë, i kishin caktuar ndonjë detyrë në veçanti?
Pë. *[REDAKTUAR]*.
Py. Sa herë ke pas kontakte me atë?
Pë. Kam pas edhe në jetën private edhe në jetën ushtarake, kam pas kontakte me të.
Py. Në *[REDAKTUAR]* tënden, lidhur me çfarë kishe kontakt me të?
Pë. Po në, ka qenë në organizim të Ushtrisë Çlirimtare në Gollak si çdo tjetër, kështu që kemi pas kontakte normale të vazhdueshme, kemi pas kontakte.
Py. Po pse si *[REDAKTUAR]* ti kishe kontakte me atë? *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Py. Po, por ty *[REDAKTUAR]*.
Mund të japësh shembull, për shembull çfarë lloj çështjesh

problemesh diskutoje me *[REDAKTUAR]*?
Pë. Po nuk më kujtohet tash të sakta çfarë çështjesh kemi bisedu. Kemi bisedue në mënyrën e organizimit, në mënyrën e -- jetën private të njerëzve tonë të familjeve tona edhe kena mujt me bisedue në mënyrë shoqërore kena ndejt. Nuk o konë e thonme që na kena ndejt gjithmonë në front t'ue prit për shembull armikun, po kemi ndejt edhe në mënyrë të lejume, në mënyrë të lirë kemi ndejt kemi bisedue edhe jashtë kompetencave ushtarake kemi ndejt nëpër oda, nëpër familje nëpër këto. Kena ndejt kena bisedu në atë aspekt po thomë unë, që kom ndejt ma shumë me të.
Py. Gjatë luftës, a ke diskutuar ndonjëherë për çështje sigurie me *[REDAKTUAR]*?
Pë. Jo, s'kam bisedu.
Py. Pse jo?
Pë. S'kam pas nevojë.
Py. Po pse jo?
Pë. Po kur mu ka dhënë nevoja, kam mujt me diskutu me *[REDAKTUAR]* e me çdo epror kam diskutu, kur u konë e nevojshme. Kur s'a konë e nevojshme s'kam pas nevojë me diskutue, kështu që s'e kom diskutu se s'kam pas arsye për çka me u diskutu me të.
Py. A dini nëse ka qenë një person në atë brigadë me emrin Sali?
Pë. Edhe një herë emrin?

Py. [Nuk ka përkthim].
Pë. Salih?
Py. Nëse ky është shqiptimi, po.
Pë. Po.
Py. Kush ishte ky?
Pë. Tash kanë qenë dy Saliha.
Py. [Nuk ka përkthim].
Pë. Salih Mustafa edhe një Salih mbiemrin nuk ia di.
Py. Ky personi tjetër, ku ishte i vendosur ky tjetri?
Pë. Ky ka mujt me konë herë në bazë, herë nëpër pika të caktume, herë në bazë të Skifterave, herë te baza e Karadakut. kështu që -- herë në Llap ka pas lëvizje.
Py. Ky Salihu, çfarë detyre i kishin ngarkuar këtij, nëse e di?
Pë. Nuk e di
Py. E ke takuar personalisht ti këtë?
Pë. Po, unë e kom takue rrugës e kom takue, kështu ndejt kur kemi ndejt e kom taku.
Py. Për çfarë ke diskutuar me atë, carë lloj gjërash ke diskutuar me atë? Profesionale apo lidhur me pozicionet tuaja?
Pë. Në mënyrë të thjesht në mënyrë private ndoshta kështu, se jo diçka në mënyrë -- në atë kuptimin ushtarak diçka, jo 'skam diskutu kurrgjo me të.
Py. E di cilin ka pas epror ai?
Pë. *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]* mendoj që a konë, tash nuk e di.
Py. Nëse takoheshe me atë tamam tamam ku takoheshe, mund të na thuash në ç'vend?
Pë. Kah kemi kalu, unë kom lëviz knejna, ai ka lëviz knejna, jem taku me të. Jem taku në ndonjë vend, ndonjë odë, ndonjë ka jemi konë me qytetarë, jemi takue e kam pa, e di e di që u kon me atë emër. Edhe e kom njoft kështu si figurë, si figurë e kom njoft, që ka qenë aty.
Z. VON BONE: [Përkthim] Dua të kaloj në seancë private shumë shkurt. Pastaj kam edhe diçka për të diskutuar.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat nuk e kisha për të qenë shumë shkurt, por më shumë për Dëshmitarin.
Kur të japësh përgjigje, mos të identifikosh veten me ato që thua, se dy herë e përmende për shembull që ke qenë në *[REDAKTUAR]*, në atë *[REDAKTUAR]*. Ne e kemi hequr faktikisht nga transkripti nga procesverbali.
Mirë do të kalojmë në seancë private.
DËSHMITARI: Kërkoj falje.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare të kalojmë në seancë private ju lutem.
~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]
SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Tani jemi në seancë private. Në seancë publike duhet të tregojmë kujdes veç.

DËSHMITARI: Faleminderit.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. A e di nëse ka pasur ndonjë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* nga Presheva? Nga fshati Preshevë?

Pë. Fshati Preshevë s'është, po asht qytet ku thirret *[REDAKTUAR]*. Po megjithatë nuk e di që ka qenë në *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, po e di që ka qenë ushtar.

Py. Ja di emrin?

Pë. Po. *[REDAKTUAR]*.

Py. Ky është emri nofka pseudonim, a emri i vërtetë?

Pë. Nuk e di, veç kështu e kanë qujt. Nuk e di.

Py. Po ku ishte i vendosur ky?

Pë. *[REDAKTUAR]*

PY. A mund të na e përshkruash kështu nga pamja si ishte? Në dukje?

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Py. Ishte i vendosur në kompleks ky?

Pë. Po e kom pa, shumë herë e kom pa që ka qenë atje tash, me siguri po.

Py. Ishte i *[REDAKTUAR]* ai?

Pë. Nuk e di.

Py. A mundesh emrin t'ia përsëritësh se sikur nuk e kuptova? Nuk e lexoj dot.

Pë. *[REDAKTUAR]*, kështu më duket mbiemri. *[REDAKTUAR]*.

Py. Z. Dëshmitar, një pyetje më shumë për vendndodhjen në Zllash. Na the se ishte kompleksi i ndërtesave të një familjeje aty?

Pë. Për ku e ke fjalën se Zllashi është, ka komplekse shumë të familjeve, shumë lagje. Saktësisht për ku e ke fjalën.

Py. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Po. Për q'atë kompleks mujt me fol veç atë çka e di edhe ça kam pa. Ai asht pikërisht në Zllash, në pikën ma të naltë të Zllashit. Nëse lypet vendndodhja e tijna, është pika ma e naltë e Zllashit ku ka qenë ai kompleks.

Py. Në veçanti cilët fqinjë kishte kjo familje që jetonte aty?

Pë. Po kishte lagjen Cubaj, kishte lagjen e Sobve kishte lagje të tjera që s'më kujtohen me emra kështu. Do të thotë kjo ka qenë pika ma e naltë në këtë lagje, kjo familje.

Py. Por në kompleksin e kësaj familje, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Po ka qenë edhe ata janë të fisit të tyne Sfarc, të Eminit edhe të Smajlit, ku kanë qenë të bashkangjitun mrapa. Mrapa apo para nuk e di saktë, të atij kompleksi. Po janë

kushërinj mes veti.

Py. Z. Dëshmitar, do të mbështetem tani, do t'i referohem një dokumenti, është me numër ERN 072914 TR-ET Pjesa 3 E rishikuar RED3. Në veçanti është faqja 27 e këtij transkripti. Është transkripti i datës 21 janar 2020. Nëse e kemi këtu, do të flas për rreshtat nga rreshti 10 deri në rreshtin 21.

Faqja 27, rreshtat nga 10 deri në 21 të pjesës së tretë. Thjesht desha të sigurohem që të gjithë e kemi hapur në të njëjtën vend. Z. Dëshmitar, më datë 21 janar të vitit 2020 i ke thënë në intervistë ZPS, Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe kjo pjesë ka të bëjë me faktin se *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]* A mund të më thuash se çfarë deshe me thënë ti me këto fjalë se "nuk du të më thërrasi gjykata mua"?

Pë. Po, po të tregoj pse më për çka me më thirr mua gjykata dhe me gjithë që jam i obligum me tregu të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, për atë arsye kam thonë që, unë do ta tregoj të vërtetën. Kurdo qoftë qe të jenë, unë do tregoj të vërtetën deri aq sa e di unë, deri ku ka shku procedura e tijna. Ma andejna nuk di unë. Për atë arsye i kam thonë edhe ashtu.

Py. Pastaj ke thënë që *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]* Z. Dëshmitar, tani du me të pyet.

Pë. Unë rrethanat nuk i di as qysh asht vrarë, as që asht i vrarë a, as qysh u vra, as ku u vra. Po megjithatë rrugëtimi i tijna peej aty deri aty, unë atë e kam cekë që e kom me thonë të vërtetën. Se unë nuk di unë ma shumë, se aty janë vra ndoshta shumë janë vra prej forcave serbe janë vra civilë, janë vra pleq e plaka fëmijë, janë vra ma shumë prej granatimeve. *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]* Z. Dëshmitar të lutem a mund ta shpjegosh se çka ke dash me thanë me këtë?

Pë. Pasi kemi bisedue që forcat serbe kanë granatue edhe kanë vra shumë civil, rrethanat i sqaron ai që e din si ka ndodhë ose vrasja e tina ose vdekja e tina. Se unë nuk e di, se u kam qenë në distancë të largt që nuk kom mujt me e dit për shembull rrethanat e tijna, as nuk i kom dit as sot dhe atë ditë nuk i di. Kjo ka qenë arseyja që kemi bisedu e kom dash me thonë për atë.

Py. Domethënë për të qenë të qartë, ti nuk e din nëse Salih Mustafa i ka dit rrethanat në të cilat asht vra ai?

Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Py. [Pa përkthim].

Pë. Nuk kam përkthim.

Py. Do ta përsëris edhe një herë pyetjen. A mund të dëgjosh tash?

Pë. Po.

Py. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
Pë. Po, vetëm ka qenë.
Py. Dhe ku ka ndodh ky takim kur e ke diskutu këtë punë me të? Në të cilin vend?
Pë. Ka ndodh në Prishtinë. Saktësisht vendin nuk e di, veç ka ndodh në Prishtinë dikund.
Py. Edhe ky takim a u ba me nismën tënde, me iniciativën tënde apo me iniciativën e tij?
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Py. E pse e zgjodhët bash at vend për t'u taku?
Pë. Nuk e zgjodha unë, po aty kish qenë ai. Se as s'e zgjodha unë, as nuk e zgjodhi ai. Aty kish qenë t'u pi kafe, kur e kam thirr në telefon, "po du me u taku me ty". Ka thonë "jam këtu" në këtë lokal. Dhe kom shku tek ai lokali, kemi bisedu.
Py. A të kujtohet se çfarë periudhe kohore ka ndodh kjo bisedë, faktikisht në të cilën pjesë të ditës ka ndodhë kjo biseda, ka ndodh në mëngjes a mbasdite a në mbrëmje?

Pë. Jo, ka mesi i ditës dikun ka qenë.

Py. Edhe a të kujtohet data përafërsisht se kur është zhvillu ky takim?

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Py. Faleminderit z. Dëshmitar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja kryetare e Trupit Gjykues, me kaq kam përfunduar pyetjet për këtë Dëshmitar. Ju falënderoj juve dhe falënderoj Dëshmitarin për përgjigjet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Në përputhje me rregullin 127.3 të Rregullores së procedurës dhe provave, Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje plotësuese prej palët thirrëse dhe ju Z. De Minicis thatë që do ta shikoni edhe një herë transkriptin gjatë fundjavës dhe do të na tregoni sot në qoftë se keni pyetje plotësuese për Dëshmitarin.

A keni pyetje plotësuese dhe sa kohë do t'ju duhet.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Vetëm disa pyetje. Ju faleminderit. Nuk mendoj që do të më marrë më shumë se 5 minuta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, Prokurori tani do t'ju bëj disa pyetje.

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Prokuror, a doni të mbeteni në seancë private apo të kthehemi në seance publike?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mendoj që mund të kalojmë në seancë të hapur, është e sigurt.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Urdhëroni Z. Prokuror. Mund t'i bëni pyetje plotësuese Dëshmitarit. Urdhëroni.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.

Pyetje të mëtejshme Z. De Minicis:

Py. Mirëmëngjesi Dëshmitar dhe t'ju rikujtoj edhe një herë se jemi në seancë të hapur, publike dhe të jemi të kujdesshëm.

Më 24 shtator dhe kjo është në faqen 18 rreshti 20 i transkriptit të gjykimit ta asaj dite, ju na thatë se brigada 153 dhe Skifterat kanë qenë dy njësi të ndame, kanë qenë ndaras, a ju kujtohet kjo përgjigje?

Pë. Po.

Py. Sot gjatë pyetjeve të avokatit të Mbrojtjes ti the se i ke njoft dy Saliha në atë kohë. Njëri ka qenë Salih Mustafa dhe i dyti ka qenë një Salih, mbiemrin e të cilit nuk e mban mend. Dhe këtë Salihun e dytë e ke pa në atë zonë në atë kohë

gjithashtu?

Pë. Po.

Py. Na tregove që eprorët e këtij sigurisht kanë qenë eprorët e brigadës 153, a ka qenë kështu për shkak se ti e din që ai ka qenë anëtar i brigadës 153?

Pë. Po, kështu ka qenë.

Py. Dhe gjithashtu na tregove se e ke pa atë në vende të ndryshme, e përmende edhe bazën e Skifterave. Tani a ka qenë i vendosur aty, apo a ka qenë baza e Skifterave vendi ku e ke pa kohë mbas kohe, apo ka qenë ai aty i vendosur?

Pë. Jo, ndoshta u keqkuptue. Për bazë të Skifterave nuk e kam pa, po e kom pa gjithmonë në lëvizje prej brigade në pjesë të tjera pika të tjera për shembull si Buna 29, si në zonë të Llapit, si prej zonës së Karadakut. Kështu që e kam pa në lëvizje vazhdimisht e kom pa në lëvizje, po pikërisht në bazë të Skifterave nuk e kam pa.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Vetëm një minutë ju lutem, të nderuar Gjykatës.

Py. Me sa e din ti, ky Salihu tjetër a ka qenë anëtar i njësisë së Skifterave, me sa e din ti?

Pë. Nuk e di që ka qenë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës që na lejuat të bëjmë pyetje plotësuese. Nuk kemi më pyetje të tjera.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit Z. Prokuror.

Tani i drejtohem Avokates Përfaqësueses së Viktimave. A doni t'i bëni pyetje Dëshmitarit dhe në qoftë se po, sa kohë do t'ju duhet?

ZNJ. PUES: [Përkthim] A do të më jepni dy minuta që të konsultohem me kolegët e mija në lidhje me një pikë dhe do t'ju tregoj. Ju faleminderit.

[Përfaqësuesit e Mbrojtjes së Viktimave këshillohen midis tyre]

ZNJ. PUES: [Përkthim] Ju faleminderit, nuk kemi pyetje të tjera.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Avokate e Viktimave.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani i drejtohem Mbrojtjes. A keni pyetje shtesë që dalin prej pyetjeve plotësuese të Prokurorit?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Vetëm dy pyetje të shkurtra.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni.

Pyetje vijuese të mëtejshme Z. Von Bone:

Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj që është ma mirë të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund të kalojmë znj. Sekretare në seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Sekretare.

Z. VON BONE: [Përkthim]

Py. *[REDAKTUAR]* atë kompleksin e shtëpive që e diskutum, na shpjegove se ke qëndruar shumë shkurt, vetëm sa e ke dorëzuar. Në atë kohë a ke pa në qoftë se ka pas ndonjë ndërtesë që ka qenë e ruajtur me roje?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E shoh që Prokurori ka kundërshtim.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Kjo pyetje nuk del nga pyetjet plotësuese qe ia bëra unë Dëshmitarit dhe unë mendoj që nuk është me vend që kjo pyetje t'i bëhet Dëshmitarit si pyetje plotësuese e mbrojtjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. von Bone, e kuptoj Prokurorin dhe kundërshtimin që ka.

Z. VON BONE: [Përkthim] Atëherë po e riformuloj pyetjen.

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Jo, asnjëherë s'e kom pa, jo në atë kompleks po në asnjë kompleks tjetër nuk e kom pa që ka bo roje. Se ai e ka pas një pozitë, çfarë pozite ka pas nuk e di, po ka pas një pozitë ma të lartë që, s'ka bo roje. Ushtarët kanë bo roje, po ai jo.

Py. Atëherë pse ky nuk ka bo roje?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk janë pyetjet e juaja Avokat Mbrojtës që të lidhen me pyetjet plotësuese të Prokurorisë. U mundova t'ju jap pak hapësirë për të bërë pyetje por ju po e merrni të gjithë hapësirën.

Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Sekretare jemi tash në seancë private. A mund të kthehemi në seancë publike?

[Seance e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi tani në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, të kanë bërë pyetje Prokurori, Avokatja e Viktimave dhe Avokati Mbrojtës. Kërkoj që të kesh edhe pak

durim me ne, se edhe ne anëtarët e Trupit Gjykues kemi disa pyetje për ty. Me këto pyetje ne shpresojmë ta kemi më të qartë atë që na e ke thënë në dëshminë tënde deri tani.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mendoj që është më së miri tani të kalojmë në seancë private.

Znj. Sekretare a mund të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.

Pyetje nga Trupi Gjykues:

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e din në qoftë se vendimi *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* dhe për hir të procesverbalit i referohem transkriptit të datës 23 shtator, faqja 51, rreshtat 11 dhe 12. Dhe intervistës së ZPS 072914 TR-ET Pjesa 3, E redaktuar, faqja 5, rreshti 25. Pra kjo është pyetja.

Pë. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Nuk e kam pyet kurrë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani po i referohem transkriptit të dëshmisë të datës 24 shtator, faqja 16, rreshtat 15 dhe 16. Dhe deklaratës tuaj me të njëjtin numër faqja 17, rreshtat 17 dhe 19. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tash përgjithësisht, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Në dëshminë tënde na ke thanë se Salih Mustafa ishte komandant i BIA-s dhe se BIA e ka përdor këtë bazën në Zllash, i referohem transkriptit dëshmisë tënde datës 23 shtator rreshtat 23 deri 25, në faqen 44 dhe rreshtat 1 deri në 6 në faqen 45. Pyetja ime asht kjo, Salih Mustafa a ka qenë personi që e ka pas kontrollin mbi bazën e Skifterave në Zllash?

Pë. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe të ka bërë pyetje Avokati i Mbrojtjes në datën 24 shtator faqja 50, rreshtat 11 deri 25 të transkriptit. Pyetja asht kjo, na the se Agron Xhemajli dhe Fatmir Sopi dhe Salih Mustafa ndërroheshin në atë bazë. Çka ke dash me thanë me këtë ndërrimin kur ke thënë janë ndërru?

Pë. Asht keqkuptim, ndërroheshin në atë bazë jo, po ndërroshin pozicionet e tyne. Atë kam dash me thanë, pozicionet e tyne, për shembull Fatmiri ka qenë zëvendës komandant, ma vonë u bo komandant. Sejdi Veseli ka qenë shef

shtabi, ka ndryshue pozicionet e tyne, ndërrimet e pozitat tyne kanë ndryshue. Jo pozicionet lokacionet e tyne s'kanë ndryshu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta lexoj edhe një herë atë që e keni thënë.

Dhe pyetja ishte kjo: "në atë kohë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, kënd e ke taku atje".

Dhe ti je përgjigj: "kushdo që ka ndodh aty në atë kohë. Fillimisht ka qenë Salih Mustafa, Rrahman Dini, Agron Xhemajli dhe shumë të tjerë".

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhe pastaj ke thënë: "ata ndërroheshin".

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe unë prej përgjigjes tënde, përshtypja ime ishte se ata ndërroheshin aty brenda bazës së Skifterave.

Py. Jo, nuk e kam thonë me atë kuptim, po e kam thonë që aty kanë lëviz këta emrat që i përmende, kanë mujt me lëviz ata dhe shumë njerëz të tjerë. Por megjithatë përgjegjës për atë bazë ka qenë Salih Mustafa. E nuk -- nëse i referohemi ndërrimit të këtyne, nuk ka qenë ndërrim i tyne në atë bazë, po e kam pas fjalën për pozita që iu ka ndërru. A faktikisht këta kanë mujt me qenë edhe aty, kanë mujt me qenë në bazën e

Skifterave, në bazën e Buna 29, kanë mujt, se këta kanë qenë udhëheqës të brigadës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit për këtë sqarim.

Edhe një gjë tjetër që e thatë dhe kjo është në transkriptin e datës 23 shtator faqja 12, rreshtat 8 deri në 11, ju përmendët që ka pas edhe familje të tjera aty te kompleksi i Zllashit.

Pë. Po ka pas familje shumë në Zllash, se Zllashi ndahet me lagje. Po te kompleksi i Skifterave qysh e kemi qujt ne, ka pas edhe familje të tjera. Ka pas kushërinj të tina të asaj familje, ka pas refugjatë, kështu që ka pas familjarë edhe të tjerë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë a të kam kuptu drejtë se, aty brenda te baza e Skifterave, apo te kompleksi i Skifterave dhe më korrigjo nëse të kam kuptu gabim, d.m.th. sipas kësaj aty te kompleksi ka pas edhe ushtarë të BIA-s, po ka pas edhe familje që kanë jetu aty?

Pë. Jo, në atë kompleks që kanë jetue, nuk ka pas. Ata qysh herët para disa vitesh e kanë lanë atë kompleks dhe janë konë në qytet, po në rrethina në afërsi të atij kompleksi ka pas familje që kanë jetu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Tash e kam të qartë, faleminderit për këtë

qartësim.

Dhe pyetja ime e fundit është -- i referohem deklaratës së njëjtë që ja keni dhënë Zyrës së Prokurorisë faqja 16, rreshtat 10 *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Pë. Jo, s’kam mendu se s’kam pas kurrfarë ideje diçka që, ka

mundet me ndodh diçka, absolut s'kam mendu në atë drejtim kurrgjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në përgjithësi e ke mendu se kjo nuk ëashtë në rregull dhe për mendimin tim, e vetmja gjë që nuk ka qenë në rregull në atë kohë, ka qenë urdhri që ua kanë dhanë?

Pë. Po, kështu e kam mendu unë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kështu ke mendu ti, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] D.m.th. nëse ju kam kuptu drejtë, simbas jush nuk asht mirë që as njoni *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Këto ishin pyetjet e mija. Pra kjo ishte pyetja ime e fundit. Tash do të kalojmë në seancë publike.

Znj. Sekretare të kthehemi në seancë publike.

[Seance e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi kthyer sërish në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, kemi mbërritur në fund të dëshmisë suaj sot këtu në Gjykatë. Ju keni shpenzuar tre ditë me ne dhe mund ta imagjinoj që mund të kenë qenë ditë të vështira dhe të lodhshme. Dua t'ju falënderoj sepse besoj se dëshmia juaj do të na ndihmojë në përpjekjet tona për të gjetur të vërtetën. kështu që faleminderit shumë për kontributin tuaj.

Ju uroj rrugë të mbarë për në shtëpi dhe dua t'ju kujtoj që ju nuk duhet të diskutoni me askënd dëshminë që keni dhënë përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Znj. Sekretare ju lutem shoqërojeni Dëshmitarin jashtë sallës së Gjykatës.

DËSHMITARI: Faleminderit.

[Dëshmitari largohet]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani që dëshmitë e dy Dëshmitarëve të parë të ZPS kanë përfunduar, dua t'ju kujtoj palëve sa i takon procedurave për parashtrimin e materialeve përmes një Dëshmitari. Këtë e kemi parashikuar në fakt edhe në sjelljen e procedurave në paragrafin 37 të këtij vendimi dhe këtu përfshihen të gjitha materialet të cilat prodhohen gjatë dëshmisë së Dëshmitarëve, të tilla si për shembull dokument, skicat të cilat janë hartuar dhe janë shënjuar nga Dëshmitarët gjatë dhënies së dëshmive të tyre.

Pyetje për palët, Avokatja e Viktimave, ka ndonjë gjë për të shtuar dhe Prokuroria.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, ne nuk kemi asgjë për të thënë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokatja e Viktimave?

ZNJ. PUES: [Përkthim] As unë nuk kam asgjë për të thënë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokati i të Akuzuarit, Z. Von Bone.

Z. VON BONE: [Përkthim] Siç e thashë Dëshmitari i radhës kur të vijë këtu në sallën e Gjyqit dhe i Akuzuari do të ndjekë seancën në lidhjen përmes videos, e kuptova që ka një lloj kërkese në këtë aspekt. Ndoshta do të ishte më mirë që ta bënim këtë të qartë në mënyrë që t'i bëjmë çështjet organizative të qarta këtu në seancën gjyqësore.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë Z. Avokat.

Dua që t'ju kujtoj që dëshmia e radhës e ZPS me Dëshmitarin W01679 më 4 tetor do të fillojë në orën 9:30. Këtu përfundon seanca.

--- Seanca mbyllet në orën 12.44 pasdite